

VENDIM
Nr. 83, datë 24.4.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“SPV BLUE 2” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.4.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1496/2 prot., datë 23.4.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SPV Blue 2’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “SPV BLUE 2” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1496 prot., datë 10.4.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë, duke plotësuar formularin sipas formatit të shtojcës 1. Aplikuesi ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, ku janë plotësuar të dhënat e subjektit, përfshirë emrin, NUIS-in, adresën, numrin e telefonit, adresën e e-mailit dhe administratorin. Aplikuesi deklaroi se nuk i është hequr ose refuzuar më parë ndonjë licencë për operimin në sektorin e energjisë elektrike brenda ose jashtë vendit, është njohur me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi dhe angazhohet për respektimin e tij, si dhe të rregullave dhe rregulloreve të miratuara nga ERE. Gjithashtu, aplikuesi ka deklaruar se dokumentet dhe të dhënat e paraqitura për qëllime të këtij aplikimi janë të vërteta, duke qenë i vetëdijshëm për përgjegjësitë ligjore në rast të deklarimit të të dhënave të pavërteta ose paraqitjes së dokumentacionit të falsifikuar. Aplikuesi është i gatshëm të paraqitet në ambientet e ERE-s në rast se do të jetë e nevojshme zhvillimi i ndonjë seance dëgjimore gjatë procedurës së shqyrtimit të aplikimit, si dhe ka kryer pagesën e tarifës së aplikimit më datë 15.4.2025, pranë Bankës “Tirana Bank” sh.a., në përputhje me përcaktimet e aneksit A të rregullores.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave (“a”, “c” dhe “d”). Shoqëria ka paraqitur ekstraktin historik të regjistrimit tregtar, të vulosur elektronikisht nga QKB-ja më datë 26.3.2025, nga i cili rezulton se “SPV Blue 2” sh.p.k. është regjistruar më datë 17.3.2021 si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Në përmbushje të kërkesës së germës “c”, shoqëria ka dorëzuar strukturën organizative, e cila përfshin Asambleenë e Aksionerëve, Administratorin, Departamentin Teknik (me nënkontraktorin për operim dhe mirëmbajtje, menaxherin e operimit, përgjegjësin për lejet dhe autorizimet dhe zyrën e Shëndetit dhe Sigurisë Mjedisore), Departamentin e Administratës (me sektorin e financës, juridikun, prokurimin/logjistikën dhe asistentët ekzekutivë), si dhe Departamentin e Shitjes (për shitjen, skedulimin, matjet dhe balancimin). Nga verifikimi i këtij dokumentacioni rezulton se shoqëria zotëron

strukturën e nevojshme për të ushtruar veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Në lidhje me germën “d”, konstatohet se nuk aplikohet, pasi shoqëria nuk ka caktuar një përfaqësues ligjor dhe për rrjedhojë nuk ka depozituar akt përfaqësimi në ERE.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3, germa “a” të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin që vërteton mungesën e detyrimeve të pashlyera ndaj organeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Shoqëria ka depozituar në ERE vërtetimin e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve DTM, më datë 26.3.2025, nga i cili rezulton se “SPV blue 2” sh.p.k. nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri në datën e lëshimit të këtij vërtetimi. Gjithashtu, është paraqitur vërtetimi i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Tiranë, më datë 26.3.2025, që konfirmon mungesën e detyrimeve të papaguara lidhur me kontributet për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi, deri në datën e lëshimit të dokumentit.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1496/1 prot., datë 15.4.2025, shoqëria ka depozituar mandatin për kryerjen e pagesës së aplikimit. Në këto rrethana, edhe afati i shqyrtimit të këtij aplikimi do të fillojë nga kryerja e pagesës.

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”:

Në mbështetje të germës “b”, aplikuesi ka paraqitur vërtetimin e gjendjes gjyqësore për administratorin e shoqërisë, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me nr. kërkesë 20, datë 11.3.2025, nga i cili rezulton se administratori është i padënuar. Gjithashtu, është dorëzuar vërtetimi i gjendjes gjyqësore për shoqërinë, me nr. 19 prot., datë 6.3.2025, nga i cili rezulton se shoqëria “SPV BLUE 2” sh.p.k. është e padënuar. Megjithatë, vlerësohet se ky dokument duhet të jetë i përditësuar, pasi është lëshuar më herët se një muaj nga data e paraqitjes së aplikimit, dhe për këtë arsye kërkohet që shoqëria të depozitojë një vërtetim të ri.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “b”:

Aplikuesi ka dorëzuar pasqyrat financiare të audituara për vitet kontabël 2022, 2023 dhe 2024, nga të cilat rezulton se për vitet 2023–2024 shoqëria ka realizuar shpenzime për paga, sigurime shoqërore dhe investime, por nuk ka gjeneruar fitime. Shoqëria ka dorëzuar parashikimin për furnizimin me energji elektrike në pesë vitet e ardhshme, duke parashikuar për vitin e parë furnizimin e një sasie prej 99,585 MWh/vit, ose rreth 8,299 MWh për një muaj. Në planin e biznesit është bërë përlllogaritje duke u mbështetur fillimisht në bursën HUPEX, por në përputhje me kërkesat specifike të rregullores dhe vendimin unifikues të Bordit të ERE-s nr. 16, datë 16.1.2025, përlllogaritjet janë përshtatur sipas çmimit mujor të ALPEX-it për muajin mars 2025. Duke qenë se nga pasqyrat financiare rezulton se shoqëria nuk ka të ardhura të mjaftueshme për të garantuar mbulimin e kësaj vlere dhe nuk ka paraqitur dokumentacion tjetër mbështetës financiar, vlerësohet që të kërkohet nga shoqëria plotësimi i dokumentacionit për mbështetjen financiare të kërkuar në zbatim të rregullores, për të mbuluar të paktën 1 muaj të ushtrimit të aktivitetit të furnizimit të energjisë elektrike.

- germa “c”:

Në përputhje me nenin 9, pika 1.3, germa “c” të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar planin e biznesit për periudhën 2025–2030, i cili përfshin analizën e tregut për vitet 2021–2024 dhe projeksionet për kostot, shitjet dhe të ardhurat për pesë vitet e ardhshme. Nga shqyrtimi i dokumentit rezulton se veprimtaria e furnizimit pritet të kontribuojë në furnizimin e klientëve dhe në rritjen e të ardhurave të shoqërisë. Megjithatë, sa i takon modalitetit të financimit të veprimtarisë së furnizimit, plani pasqyron të ardhura të parashikuara nga veprimtaria e prodhimit të energjisë elektrike, aktivitet i cili ende nuk

ka filluar, pasi energjizimi i veprës është parashikuar të realizohet jo më vonë se data 17.3.2026, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 296, datë 30.12.2024. Në këto kushte, mbështetja financiare për furnizimin nuk është definuar plotësisht dhe kërkohet sqarim i mëtejshëm.

Pika 2.4. Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike

- **germa “b”:**

Shoqëria ka deklaruar se do të instalojë një sistem SCADA për menaxhimin e operimit me rrjetin. Megjithatë, në lidhje me kërkesat specifike të kësaj pike, vlerësohet se aplikuesi duhet të plotësojë informacionin edhe për sistemin IT që do të përdoret për realizimin e procesit të faturimit të klientëve që do të furnizojë.

- **germa “c”:**

Shoqëria duhet të bëjë me dije nëse këto zyra të cilat rezultojnë si seli e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike (pra, vendndodhja e centralit prodhues), janë vlerësuar se do të jenë edhe zyrat të cilat do t'i shërbejnë aktivitetit të furnizimit për shërbimin ndaj klientit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti